

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E ENJTE 23 QERSHOR 2022

U fol për zonat e mbrojtura. Më lejoni të ndaj me ju, ta risjell në vëmendje faktin se jo më larg se sa janari i këtij viti qeveria shqiptare mori një vendim, me të cilin zgjeroi zonat e mbrojtura në territor nga 17% e territorit në 21%. Pra, jo vetëm duke e shtuar këtë sipërfaqe, por duke filluar njëkohësisht edhe një përgatitje shumë serioze për të rritur shkallën e mbrojtjes së parqeve natyrore, siç nisëm të bëjmë me parkun natyror të Vjosës, për ta çuar në një shkallë më të lartë, në park kombëtar.

Është një rast i rrallë në Europë kur një lumë, i fundit lumë i egër në Europë, do të shpallet “Park kombëtar” falë një bashkëpunimi me ekspertizën më të mirë kombëtare dhe ndërkombëtare për të bërë një model të pashoq në Europë se si një luginë lumi mbi 270 kilometra nga kufiri me Greqinë dhe deri në bregdet të shpallet “Park kombëtar” bashkë me një plan menaxhim, i cili do t’u propozohet banorëve të të gjitha bashkive nga: Përmeti, Këlcyra, Tepelena, Mallakstra, Memaliaj, Libohova, Gjirokastra, duke përfshirë Selenicën, përfshirë edhe dy degët, Shushicën dhe Drinosin, si një model të zhvillimit të qëndrueshëm. Ky është projekti më i fundit.

“Syri i Kaltër” kishte statusin “Monument natyre” vetëm burimi, ai “Syri i Kaltër”, që ne shikonim. Sot kemi park natyror me sipërfaqe 292 hektarë, pikërisht për të mbrojtur atë që është monument i natyrës, ku sapo është bërë një investim për të shmangur atë batërdi që kemi pasur, kur sulleshin me makina e me gjithfarë gjërash për ta përdorur si pishinë monumentin e natyrës, por që nga ky moment nuk lejohet më. Do të jetë vetëm rrugë këmbësore, për kalim me biçikleta apo me shtigje shëtitore. Ju ftoj të vini ta shikoni, ta vizitoni e ta shijoni, sepse është një ndër punët e mira që ne po bëjmë në zonat e mbrojtura. Sa i përket aeroportit të Vlorës, njolla e projektit është në një zonë, që sot me ligj, me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit të 2020-ës nuk është zonë e mbrojtur dhe gjendet në njollën e vjetër të aerodromit.

Të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji për dëgjesat publike dhe për lejet mjedisore, që më tej kanë prodhuar lejen e zhvillimit, të dhënë nga Këshilli Kombëtar i Territorit, janë respektuar një më një. Çdo koleg deputet apo media e interesuar për informacion, mund ta marrë informacionin pranë Ministrisë së Mjedisit, pa asnjë lloj problemi, siç e kemi dhënë e ridhënë tashmë disa herë. Prandaj, kur flasim është mirë të shikojmë realisht çfarë po ndodh. Mirë është të kujtojmë se çfarë ka ndodhur me këto zona të mbrojtura të Parkut Kombëtar të Butrintit.

Në hartën e vjetër të Parkut Kombëtar të Butrintit, për të cilën, sipas perceptimit tuaj mendoni se është vetëm qyteti antik, në të vërtetë është një zonë shumë më e gjerë, që përfshinte edhe atë që ne sot e quajmë Ksamil, e ku në këto vite tranzicioni lejuam të ndërtohej kuturu, si në shumë brigje të Shqipërisë, gjë që bëri të humbnin të gjitha arsyet për të qenë pjesë e florës dhe e faunës, sepse u batërdis nga ndërtimet. Sot, pasi mijëra e mijëra banorë, të cilët e jetuan dhe e urbanizuan mirë a keq, pa kontroll, në kontekstin e planifikimit të territorit, në kontekstin e zbatimit të detyrimeve të konventave ndërkombëtare për të përditësuar dhe rishikuar rregullisht zonat e mbrojtura kulturore e natyrore, janë bërë rishikime dhe falë këtyre rishikimeve janë kryer korrigjime në zonat e dëmtuara nga tranzicioni i gjatë, si dhe janë shtuar zona të tjera për t'i futur në mbrojtje.

Po ju them se do ta vazhdojmë punën me shtimin e territorit me zona të mbrojtura natyrore, sepse natyrën nuk e duam për sot, por e duam për sot e për nesër. Ama e duam me plane e me logjikë, jo me zhurmë e batërdis.